



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E KULTURËS

KËSHILLI KOMBËTAR I TRASHËGIMISË KULTURORE MATERIALE

Nr. 594 Prot.

Tiranë, më datë 14.04 2020

VENDIM

Nr. 113, datë 14.04.2020

Në mbështetje të Ligjit Nr. 27, datë 17.05.2018 “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”, neni 48 dhe neni 134, pika 1, dhe V.K.M Nr. 208, datë 10.04.2019 “Për Përbërjen, Mënyrën e funksionimit, Kompetencat dhe Shpërblimin e Anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale”, pas shqyrtimit më parë në Këshillin Teknik të konceptit të sondazheve arkeologjike, Këshilli Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore Materiale, në mbledhjen e datës 14.04.2020,

VENDOSI:

1. Miratimin e konceptit të sondazheve arkeologjike për projektin “Rehabilitimi i rrugës së “Dëshmorëve” nga kryqëzimi i sheshit “Pranvera”, deri te kryqëzimi me rrugën “Mujo Ulqinaku”, zona arkeologjike “B”, Durrës, të realizuar nga subjekti i licencuar në arkeologji znj. Lida Miraj;
2. Në përputhje me sugjerimet e KKTKM, sondazhet e propozuara nga subjekti i licencuar në arkeologji, të realizohen në formë trenchi dhe sipas shpërndarjes së potencialit arkeologjik të paraqitur nga IA;
3. Subjekti aplikues duhet të vijojë me procedurën ligjore për miratimin sipas legjislacionit për planifikimin dhe zhvillimin e territorit;
4. Subjekti Fondi Shqiptar i Zhvillimit duhet të lidhë paraprakisht akt-marrëveshje 3 palëshe me subjekt të licencuar për kryerjen e sondazheve arkeologjike sipas konceptit të miratuar dhe Institutit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore që do të mbikëqyrë këtë subjekt.
5. Gjatë procesit të zbatimit, siç parashikon dhe legjislacioni për trashëgiminë kulturore, punimet të mbikëqyren sipas Ligjit Nr. 27, datë 17.05.2018, “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”, nenet 144-147;
6. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij Vendimi;
7. Ndaj Vendimit mund të ushtrohet ankimi në gjykatën kompetente për shqyrtimin e mosmarrëveshjeve administrative. Ankimi nuk pezullon zbatimin e aktit administrativ.

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

SEKRETAR

Arta DOLLANI

KRYETAR

Elva MARGARITI

